

**Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” prezantoi rezultatet e hulumtimit “Njohuritë dhe qëndrimet e adoleshentëve për problemin e narkomanisë”**

# Problemi i narkomanisë është shqetësues

**Psikologja Ardita Kovaçi ka thënë se të dhënat e hulumtimit se 6 për qind e të anketuarve e kanë provuar drogën, “është një shenjë, një alarm, se ky i ri më vonë edhe mund të konsumojë drogë ose t’i animojë të tjerët që të vazhdojnë në këtë rrugë”. Ajo i ka cilësuar shqetësuese të dhënat e hulumtimit se 47 për qind e të rinjve njohin dikë që merr drogë**

Ulqin – Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” prezantoi të martën në një konferencë për shtyp rezultatet e hulumtimit “Njohuritë dhe qëndrimet e adoleshentëve për problemin e narkomanisë”, i cili është realizuar në partneritet me Zyrën për Parandalimin e Narkomanisë të Komunës së Ulqinit.

Asistentja e projektit Ilirjana Boci, psikologe, ka treguar se hulumtimi është realizuar në periudhën tetor – dhjetor të vitit të kaluar dhe se gjithsej janë anketuar 300 nxënës, nga klasa e nëntë e shkollave fillore “Marshall Tito” dhe “Boshko Strugar”, si dhe nxënës të gjimnazëve “Vëllazërim Bashkim” dhe “Drita”.

“Moshë e nxënësve të anketuar është 14-18 vjeç, për vetë faktin se në këtë moshë ndodhin shumë ndryshime në sjelljet dhe qëndrimet e tyre”, ka thënë ajo.

Përfaqësuesja e Zyrës për Parandalimin e Narkomanisë të Komunës së Ulqinit, Rajka Prodanoviq, ka thënë se në bazë të hulumtimit të kryer, është evidente se problemi i narkomanisë është shqetësues dhe kërkon përkushtim maksimal, ku duhet t’i kushtohet vëmendje e posaçme ngritjes së vetëdijes së të rinjve në luftë kundër

drogës.

“Komuna e Ulqinit ka qenë gjithmonë e gatshme deri tani dhe do të jetë edhe në të ardhmen në ofrimin e mbështetjes maksimale dhe të marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet me të rinj në qytetin tonë”, është shprehur ajo.

Duke komentuar rezultatet e hulumtimit, psikologja Ardita Kovaçi ka thënë se ato janë domethënëse.

Sipas saj, të dhënat e hulumtimit se 6 për qind e të anketuarve e kanë provuar drogën, “është një shenjë, një alarm, se ky i ri më vonë edhe mund të konsumojë drogë ose t’i animojë të tjerët që të vazhdojnë në këtë rrugë”.

Kovaçi i ka cilësuar shqetësuese të dhënat e hulumtimit se 47 për qind e të rinjve njohin dikë që merr drogë.

Ajo ka thënë se nuk mjafton vetëm informimi i të rinjve mbi pasojat e narkomanisë, por nevojitet edhe edukimi i tyre. Për këtë arsye, ajo e ka vlerësuar pozitive punën e “Horizontit të Ri” në edukimin e një grupi të të rinjve, të cilët do të kenë rolin si edukatorë të bashkëmoshatarëve. Njëra ndër anketueset, Arlinda Osmanoviq, nxënëse e Shkollës së Mesme

“Vëllazërim Bashkim”, ka thënë se të rinjtë në Ulqin nuk brengosen shumë sa i përket problemit të drogës.

Sipas saj, rezultatet e anketës tregojnë se 36 për qind e të anketuarve e fillojnë drogën thjesht për t’u dalluar në shoqëri.

“Megjithatë, unë si vullnetare dhe si bashkëmoshatare e tyre, me shumë të rinj të tjerë të entuziazmuar luftojmë kundër drogës duke iu ngritur vetëdijën, duke iu folur sa më shumë sepse kush mund të ndikojë tek ata më shumë sesa ne të rinjtë apo shokët e tyre”, ka thënë ajo, duke bërë thirrje që së bashku të luftojmë “për këtë vend dhe për të rinjtë, pa probleme me narkotikët apo një shoqëri të edukuar më mirë”.

Mbi rezultatet e hulumtimit kanë folur edhe asistentja e projektit Biljana Bevenja dhe nxënësjja Lenka Llallovicq.

Hulumtimi “Njohuritë dhe qëndrimet e adoleshentëve për problemin e narkomanisë” është kryer në kuadër të projektit “Partneriteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikucencës së të miturve”, të cilin “Horizonti i Ri” e realizon me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Podgoricë, përmes Zyrës për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit.

Qëllimi i këtij projekti është ngritja e vetëdijësisë së adoleshentëve mbi efektet e dëmshme të abuzimit me droga dhe ulja e sjelljeve antisociale dhe delikucencë të të rinjve në komunitetin tonë.

Ky është hulumtimi i tretë që Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” realizon mbi problemet e përdorimit të drogës nga të rinjtë pas hulumtimeve të kryera në vitin 2004 dhe 2009.

**i.k.**

